

EKONOMI

NDIKIMI I INVESTIMEVE TË HUAJA DIREKTE NË RITJEN EKONOMIKE

Marsida HARREMI

Amarda SARDI

Departamenti i Financës dhe Kontabilitetit

Fakulteti i Ekonomisë

Universiteti “Fan S. Noli”

Abstrakt

Qëllimi kryesor i këtij punimi është të evidentojë nëse investimet e huaja krijojnë një marrëdhënie shkakësore me rritjen ekonomike në Shqipëri. Gjithashtu në këtë punim kërkojmë të shohim nëse ka një ndikim pozitiv apo negativ të investimeve të huaja direkte mbi rritjen ekonomike, si dhe të përcaktojmë masën e impaktit që krijojnë IHD-të mbi rritjen ekonomike në prezencë të variablave të kapacitetit absorbues. Përmes një analize ekonometrike është trajtuar ndikimi i investimeve të huaja direkte në rritjen e Produktit të Brendshëm Bruto në Shqipëri, duke marrë në shqyrtim të dhënat e një periudhe 24-vjeçare. Nga realizimi i testeve rezulton se vlerat e variablave kanë shpërndarje normale. Modeli ekonometrik ka formë lineare dhe lidhja midis dy variablave të marrë në studim është e fortë dhe pozitive. Ndikimi i investimeve të huaja direkte është pozitive dhe domethënëse për ekonominë shqiptare.

Fjalët kyçe: Investimet e huaja direkte, Produkt i Brendshëm Bruto, rritje ekonomike, model ekonometrik

Abstract

The main purpose of this paper is to identify whether foreign investments create a causal relationship with economic growth in Albania. Also, in this paper, we seek to see if there is a positive or negative impact of foreign direct investment on economic growth, as well as to determine the extent of the effect created by FDI on economic growth in the presence of absorptive capacity variables. Through an econometric analysis, the impact of foreign direct investments on the development of the Gross Domestic Product in Albania has been addressed, considering the data of 24 years. From the realization of the tests, it results that the values of the variables have a normal distribution. The econometric model has a linear form and the relationship between the two variables taken in the study is strong and positive. The impact of foreign direct investments is positive

and significant for the Albanian economy.

Keywords: *Foreign direct investments, Gross Domestic Product, economic growth, econometric model*

1. HYRJE

Investimet e Huaja Direkte janë një përbërës i rëndësishëm i zhvillimit të sektorit privat dhe një kusht apo kontribut për zhvillimin ekonomik të Shqipërisë. Nisur nga kjo pikëpamje, politikat nxitëse për tërheqjen e IHD-ve kanë qenë dhe mbeten sfidë dhe një nga objektivat kryesore të qeverisë shqiptare, e cila po bën përpjekje në krijimin e një mjedisi tërheqës për investitorët e huaj, të shoqëruar me një kuadër ligjor të përshtatshëm.

Niveli i IHD-ve në Shqipëri gjatë viteve të fundit, në krahasim me burimet e tjera, ka qenë një burim shumë i rëndësishëm i kapitalit të huaj për financimin e deficitit koherent. Heqja e barrierave administrative ndaj këtyre investimeve, si dhe vendosja e një kuadri ligjor liberal, kanë krijuar një klimë më të favorshme për investimet. Fokusi për zhvillimin e ardhshëm të ekonomisë shqiptare do të mbetet në tërheqjen e IHD-ve me një vëmendje në sektorë ku ekonomia shqiptare ka potenciale të pashfrytëzuara, si në aspektin e burimeve natyrore, ashtu edhe në zhvillimin e sektorëve të pazhvilluar, si: turizmi, energjia, bujqësia, agrobiznesi, infrastruktura dhe shërbimet. Sektori i IHD-ve në Shqipëri përfaqëson kryesisht sektorin privat dhe ka kontribuar fuqishëm në terma të rritjes së PBB-së dhe punësimit. Lidhja ndërmjet IHD dhe rritjes ekonomike është e ndërlikuar dhe shumëdimensionale. Ndikimi pozitiv i IHD varet nga faktorë të ndryshëm, përfshirë politikat qeveritare, mjedisin ekonomik dhe kapacitetet institucionale të vendit pritës. Për të maksimizuar përfitimet e IHD dhe për të minimizuar ndikimet negative të mundshme, vendet pritëse duhet të zhvillojnë politika dhe strategji të mira për tërheqjen dhe menaxhimin e këtyre investimeve.

2. QËLLIMI

Qëllimi kryesor i këtij artikulli është të trajtojë lidhjen e IHD-ve dhërritjen ekonomike në Shqipëri. Kjo marrëdhënie është parë me interes të trajtohet sepse sot më shumë se kurrë po i kushtohet vëmendje rritjes ekonomike dhe zhvillimit të qëndrueshëm në Shqipëri, jo vetëm nga specialistë të fushës apo politikëbërësit, por edhe nga individët e thjeshtë. Ky interesim për rritjen ekonomike lidhet me rëndësinë e madhe që ka rritja ekonomike për shoqërinë në tërësi dhe për individët në veçanti. Gjithashtu, duke përdorur metoda ekonometrike, në këtë punim trajtohen faktorët përcaktues të IHD-

ve në Shqipëri dhe ndikimi i IHD-ve në rritjen e PBB-së duke marrë në shqyrtim të dhënat e një periudhe 24-vjeçare.

3. METODOLOGJIA

Marrëdhëniet midis IHD-ve dhe rritjes ekonomike janë studiuar në mënyrë intensive në literaturën e ekonomisë së zhvillimit si teorikisht, ashtu dhe empirikisht. Kohët e fundit është paraqitur interes i rritur në studimin e faktorëve përcaktues të rritjes ekonomike dhe hulumtimit të konsiderueshëm të faktorëve që ndikojnë në rritjen ekonomike.

Në këtë punimi do të realizohet një analizë ekonometrike për të parë lidhjen që ekziston midis variablilit të varur, PBB dhe variablilit të pavarur, IHD. Rezultatet e regresionit të realizuara nëpërmjet programit Eviews, do të tregojnë nëse variablat kanë shpërndarje normale ose jo dhe nëse seria kohore është stacionare apo jo. Nga analiza pritet të derivojë një lidhje e fortë midis këtyre variablave të rëndësishëm. Të dhënat për periudhën kohore 2000 – 2023, janë marrë kryesisht nga Banka e Shqipërisë dhe EUROSTAT.

3.1 KËNDVËSHTRIM TEORIK MBI VARIABLAT

- Investimet e huaja direkte

IHD-të janë një burim kryesor dhe dinamik për rritjen e investimeve dhe kapitalit për vendet në zhvillim. IHD-të përveç investimit fillestar, pasohen nga lëvizje ndërkombëtare kapitali, nga lëvizje e aftësive manaxheriale, teknologjike etj. Investimet e huaja lejojnë përparimin dhe hapjen e ekonomive në nivele ndërkombëtare duke ndihmuar në zhvillimin ekonomik të vendit pritës. IHD në Shqipëri, sikurse dhe në vendet e tjera të Evropës Qëndrore e Lindore janë një nga format e reja të depërtimit të kapitalit perëndimor, sidomos gjatë periudhës së tranzicionit drejt ekonomisë së tregut.


- Produkti i Brendshëm Bruto.

PBB është një tregues i vlerës së tregut të të gjitha të mirave dhe shërbimeve përfundimtare të prodhuara në një shtet. Ato përfshijnë gjithë prodhimet e shërbimet aktuale të destinuara për treg si dhe ato të prodhuara për konsum nga të gjitha njësitë rezidente që veprojnë në territorin e një shteti.

3.2 STATISTIKAT PËRSHKRUESE

3.2.1 Variabli I Varur Y (PBB)


Grafiku 1: Paraqitja grafike e variablilit të varur Y



Burimi: Autori, 2024

Sipas grafikut vërejmë se norma e PBB-së nga viti në vit ka qenë në rritje me përjashtim të disa viteve si rasti i pandemisë i cili ka ndikuar negativisht, viti 2020. Gjithashtu edhe kriza e vitit 2008. Para viteve 2000 shohim se niveli i PBB ka qenë shumë i ulët në krahasim me vitet më pas.

Figura 1: Histograma e shpërndarjes së vlerave për Y



Burimi: Autori, 2024

Hipotezat Jarque-Bera


H0: Shpërndarja e mbetjeve është normale

H1: Shpërndarja e mbetjeve nuk është normale

Nëse shohim të dhënat nga histograma, Skewness është i barabartë me 0.2804 që do të thotë se shpërndarja është normale dhe duke qenë se Skewness është pozitiv ka një shtypje të lehtë në anën e djathtë, ndërsa Kurtosis është i barabartë me $2.369014 < 3$, pra kemi shpërndarje platikurtike, nga këtu arrijmë në përfundimin e rëndësishëm se kemi një shpërndarje normale të vlerave të variablilit Y, ndaj në fuqi qëndron dhe na vërtetohet hipoteza bazë H0.

3.2.2 Variabli i pavarur X (IHD)


Grafiku 2: Paraqitja grafike e variablit X



Burimi: Autori, 2024

Bazuar te grafiku 2, vërejmë se norma e IHD-së nga viti në vit është në rritje me përjashtim të disa viteve ku ka pasur luhajtje.

Figura 2: Histograma e shpërndarjes së vlerave të variablit X.



Burimi: Autori, 2024

Hipoteza Jarque-Bera

H0: Shpërndarja e mbetjeve është normale

H1: Shpërndarja e mbetjeve nuk është normale

Nëse shohim të dhënat nga histograma, Skewness është i barabartë me -0.480013 që do të thotë se shpërndarja është normale dhe duke qenë se Skewness është negativ ka një shtypje të lehtë në anën e majtë, nga këtu arrijmë në përfundimin e rëndësishëm se kemi një shpërndarje normale të vlerave të variablit X, ndaj në fuqi qëndron dhe na vërtetohet hipoteza bazë H0.

3.3 KOEFICIENTI I KORRELACIONIT

Tabela 1: Koeficienti i korrelacionit midis variablave X dhe Y.

	IHD_MILIO...	PBB_MILI...
IHD_M...	1.000000	0.937538
PBB_...	0.937538	1.000000

Burimi: Autori, 2024

Koeficienti i korrelacionit midis PBB dhe IHD është 0.937538, që do të thotë se lidhja është positive dhe e fortë sepse është shumë afër 1.

3.4 AUTOKORRELACIONI

Realizojmë testin Breusch - Godfrey si më poshtë në mënyrë që të testojmë hipotezat. Statistika e këtij testi ka shpërndarje Chi-Square 0.0012.

Tabela 2: Testi Breusch - Godfrey

Breusch-Godfrey Serial Correlation LM Test:
Null hypothesis: No serial correlation at up to 2 lags

F-statistic	12.21744	Prob. F(2,21)	0.0003
Obs*R-squared	13.44500	Prob. Chi-Square(2)	0.0012

Test Equation:

Dependent Variable: RESID

Method: Least Squares

Date: 06/03/24 Time: 16:50

Sample: 1999 2023

Included observations: 25

Presample missing value lagged residuals set to zero.

Variable		Coefficient	Std. Error	t-Statistic	Prob.
PBB	MILIARDE LEKE	-0.011810	0.040803	-0.289439	0.7751
	C	10.38623	53.47194	0.194237	0.8479
	RESID(-1)	0.723909	0.221245	3.271979	0.0036
	RESID(-2)	0.038085	0.242784	0.156870	0.8768
R-squared		0.537800	Mean dependent var		1.18E-13
Adjusted R-squared		0.471772	S.D. dependent var		132.3806
S.E. of regression		96.21332	Akaike info criterion		12.11666
Sum squared resid		194397.0	Schwarz criterion		12.31168
Log likelihood		-147.4582	Hannan-Quinn criter.		12.17075
F-statistic		8.144962	Durbin-Watson stat		1.878981
Prob(F-statistic)		0.000870			

Burimi: Autori, 2024

Hipotezat

H0: Nuk ka autokorrelacion

Ha: Ka autokorrelacion

Rezultatet e testit na tregojnë se vlera probabilitare e Chi-Square është $0.0012 < 0.05$,

nga këtu mund të themi se qëndron hipoteza alternative e cila vërteton praninë e autokorrelacionit midis mbetjeve. Nga tabela 2, mund të shohim

dhe vlerën e statistikës Durbin-Watson e cila ka vlerën 1.87898 është afër vlerës 2, kjo tregon se kemi të pranishëm autokorrelacion. Për t'a eliminuar autokorrelacionin, futim variablin e varur me vonesë -1.

Tabela 3: Testi Breusch-Godfrey, pas eliminimit të autokorrelacionit.

Breusch-Godfrey Serial Correlation LM Test:
Null hypothesis: No serial correlation at up to 2 lags

F-statistic	2.524358	Prob. F(2,19)	0.1066
Obs*R-squared	5.038488	Prob. Chi-Square(2)	0.0805

Test Equation:
Dependent Variable: RESID
Method: Least Squares
Date: 06/03/24 Time: 17:29
Sample: 2000 2023
Included observations: 24
Presample missing value lagged residuals set to zero.

Variable	Coefficient	Std. Error	t-Statistic	Prob.
C	20.12886	40.00369	0.503175	0.6206
X IHD	0.034178	0.103925	0.328873	0.7458
Y_PBB(-1)	-0.040642	0.084734	-0.479642	0.6370
RESID(-1)	0.454964	0.219849	2.069436	0.0524
RESID(-2)	-0.438291	0.286460	-1.530026	0.1425
R-squared	0.209937	Mean dependent var	9.33E-14	
Adjusted R-squared	0.043608	S.D. dependent var	61.37701	
S.E. of regression	60.02383	Akaike info criterion	11.21041	
Sum squared resid	68454.34	Schwarz criterion	11.45584	
Log likelihood	-129.5249	Hannan-Quinn criter.	11.27552	
F-statistic	1.262179	Durbin-Watson stat	1.944323	
Prob(F-statistic)	0.319225			

Burimi: Autori, 2024

Nga Tabela 3 vërejmë se autokorrelacioni është shmangur. Kjo duket nga vlera Probabilitare Chi-Square $0.0805 > 0.05$ për rrjedhojë vërtetohet hipoteza bazë, pra nuk kemi të pranishëm autokorrelacionin. Gjithashtu vlerat e F-statistic dhe OBS*R-squared janë zvogeluar, gjë e cila tregon shmangien e autokorrelacionit.

3.5 STACIONARITETI I SERIVE

Meqenëse të dhënat e përdorura në analizën tone empirike janë të dhëna të serive kohore është e domosdoshme që ato të testohen për stacionaritetin. Për të qenë të sigurt dhe për të përcaktuar nëse vërtet seritë janë stacionare apo jo bëjmë testin Unit root test (ADF).

3.5.1 Unit root test (ADF) për variablin Y

Këtë test e kryjmë për tu siguruar lidhur me stacionaritetin e serisë. Testi ADF është një nga testet më të përdorura për të kontrolluar praninë e një rrënjë unitare në një seri kohore.

Tabela 4: Unit root test (ADF).

Null Hypothesis: Y_PBB has a unit root

Exogenous: Constant

Lag Length: 0 (Automatic - based on SIC, maxlag=5)

	t-Statistic	Prob.*
Augmented Dickey-Fuller test statistic	1.993614	0.9997
Test critical values: 1% level	-3.737853	
5% level	-2.991878	
10% level	-2.635542	

*MacKinnon (1996) one-sided p-values.

Augmented Dickey-Fuller Test Equation

Dependent Variable: D(Y_PBB)

Method: Least Squares

Date: 06/04/24 Time: 07:46

Sample (adjusted): 2000 2023

Included observations: 24 after adjustments

Variable	Coefficient	Std. Error	t-Statistic	Prob.
Y_PBB(-1)	0.057623	0.028904	1.993614	0.0587
C	6.513825	36.77174	0.177142	0.8610
R-squared	0.153015	Mean dependent var		75.22917
Adjusted R-squared	0.114516	S.D. dependent var		66.69892
S.E. of regression	62.76379	Akaike info criterion		11.19629
Sum squared resid	86664.45	Schwarz criterion		11.29446
Log likelihood	-132.3555	Hannan-Quinn criter.		11.22233
F-statistic	3.974498	Durbin-Watson stat		1.301752
Prob(F-statistic)	0.058738			

Burimi: Autori, 2024

Duke iu referuar testit Dickey-Fuller dhe stacionaritetit të serive kemi 2 hipoteza bazë:

H₀: seria ka rrënjë unitare ose seria nuk është stacionare.

H_a: seria nuk ka rrënjë unitare ose seria është stacionare.

Nga Tabela 4 shohim se vlera probabilitare e statistikës Augmented Dickey-Fuller (ADF) është $0.9997 > 0.05$, ndaj mund të themi se në fuqi qëndron dhe vërtetohet hipoteza bazë dhe bie poshtë hipoteza alternativë, pra themi se seria Y (PBB) është jostacionare dhe ka rrënjë unitare. Prezenca e rrënjëve unitare mund të na shkaktojë rezultate të rreme të regresionit.

Atëherë e kthejmë serinë në stacionare duke bërë diferencat e para. Nga testimi rezultoi se edhe në diferencat e para, perseri seria qëndron jostacionare. Për ta kthyer në stacionare do të bëjmë diferencat e dyta:

Tabela 5: Testi Augmented Dickey-Fuller, pas diferencave të dyta.

Null Hypothesis: D(Y_PBB,2) has a unit root

Exogenous: Constant

Lag Length: 1 (Automatic - based on SIC, maxlag=5)

	t-Statistic	Prob.*
Augmented Dickey-Fuller test statistic	-5.415753	0.0003
Test critical values: 1% level	-3.788030	
5% level	-3.012363	
10% level	-2.646119	

*MacKinnon (1996) one-sided p-values.

Augmented Dickey-Fuller Test Equation

Dependent Variable: D(Y_PBB,3)

Method: Least Squares

Date: 06/04/24 Time: 08:48

Sample (adjusted): 2003 2023

Included observations: 21 after adjustments

Variable	Coefficient	Std. Error	t-Statistic	Prob.
D(Y_PBB(-1),2)	-1.796457	0.331709	-5.415753	0.0000
D(Y_PBB(-1),3)	0.520223	0.221592	2.347657	0.0305
C	14.05336	14.64259	0.959759	0.3499
R-squared	0.670627	Mean dependent var	-4.166667	
Adjusted R-squared	0.634030	S.D. dependent var	108.1182	
S.E. of regression	65.40660	Akaike info criterion	11.33069	
Sum squared resid	77004.41	Schwarz criterion	11.47990	
Log likelihood	-115.9722	Hannan-Quinn criter.	11.36307	
F-statistic	18.32465	Durbin-Watson stat	2.104762	
Prob(F-statistic)	0.000046			

Burimi: Autori, 2024

Nga rezultatet e testit Augmented e Dickey-Fuller (ADF) më sipër shohim se vlera është 0.0003 pra më e < se 0.05 që na vërteton hipotezen alternative, seria nuk ka rrënjë unitare, pra seria është stacionare. Gjatësinë e vonesës e kemi 1, maksimumi i vonesave është 5. Variabla të jashtëm nuk kemi domethënë nuk kemi as ndikimi orientues. Themi se vlera probabilitare e D(PBB) e rendit të dytë është < 0.05 pra, PBB është e cje kuturu me ndikim orientues.

3.5.2 Unit root test (ADF) për variablin X

Tabela 6: Unit root test (ADF)

Null Hypothesis: X IHD has a unit root

Exogenous: Constant

Lag Length: 0 (Automatic - based on SIC, maxlag=5)

	t-Statistic	Prob.*
Augmented Dickey-Fuller test statistic	-0.782417	0.8061
Test critical values: 1% level	-3.737853	
5% level	-2.991878	
10% level	-2.635542	

*MacKinnon (1996) one-sided p-values.

Augmented Dickey-Fuller Test Equation

Dependent Variable: D(X IHD)

Method: Least Squares

Date: 06/04/24 Time: 09:02

Sample (adjusted): 2000 2023

Included observations: 24 after adjustments

Variable	Coefficient	Std. Error	t-Statistic	Prob.
X_IHD(-1)	-0.047175	0.060294	-0.782417	0.4423
C	87.17772	46.58101	1.871529	0.0746
R-squared	0.027073	Mean dependent var		54.83333
Adjusted R-squared	-0.017151	S.D. dependent var		104.2808
S.E. of regression	105.1713	Akaike info criterion		12.22871
Sum squared resid	243342.0	Schwarz criterion		12.32688
Log likelihood	-144.7446	Hannan-Quinn criter.		12.25476
F-statistic	0.612177	Durbin-Watson stat		1.803302
Prob(F-statistic)	0.442310			

Burimi: Autori, 2024

Duke iu referuar testit Dickey-Fuller dhe stacionaritetit të serive kemi 2 hipoteza bazë:

H₀: seria ka rrënjë unitare ose seria nuk është stacionare.

Ha: seria nuk ka rrënjë unitare ose seria është stacionare.

Nga tabela 6 shohim se vlera probabilitare e statistikës Augmented Dickey-Fuller (ADF) është $0.8061 > 0.05$, ndaj mund të themi se në fuqi qëndron dhe vërtetohet hipoteza bazë dhe bie poshtë hipoteza alternativë, pra themi se seria X (IHD) është jostacionare dhe ka rrënjë unitare. Jo-stacionariteti mund ta bëjë të vështirë modelimin dhe parashikimin e serisë kohore. Gjithashtu prezenca e rrënjëve unitare mund të na shkaktojë rezultate të rreme të regresionit Atëherë e kthejmë serinë në stacionare duke bërë diferencat e para:

Tabela 7: Testi Augmented Dickey-Fuller, pas diferencave të para

Null Hypothesis: D(X_IHD) has a unit root

Exogenous: Constant

Lag Length: 0 (Automatic - based on SIC, maxlag=5)

	t-Statistic	Prob.*
Augmented Dickey-Fuller test statistic	-4.219020	0.0035
Test critical values: 1% level	-3.752946	
5% level	-2.998064	
10% level	-2.638752	

*MacKinnon (1996) one-sided p-values.

Augmented Dickey-Fuller Test Equation

Dependent Variable: D(X_IHD,2)

Method: Least Squares

Date: 06/04/24 Time: 09:05

Sample (adjusted): 2001 2023

Included observations: 23 after adjustments

Variable	Coefficient	Std. Error	t-Statistic	Prob.
D(X_IHD(-1))	-0.974500	0.230978	-4.219020	0.0004
C	51.52620	25.16399	2.047616	0.0533
R-squared	0.458765	Mean dependent var		5.173913
Adjusted R-squared	0.432992	S.D. dependent var		144.1870
S.E. of regression	108.5727	Akaike info criterion		12.29566
Sum squared resid	247548.8	Schwarz criterion		12.39440
Log likelihood	-139.4001	Hannan-Quinn criter.		12.32049
F-statistic	17.80013	Durbin-Watson stat		1.881511
Prob(F-statistic)	0.000385			

Burimi: Autori, 2024

Nga rezultatet e testit Augmented e Dickey-Fuller (ADF) më sipër shohim se vlera është 0.0035 pra më e < se 0.05 që na vërteton hipotezen alternative, seria nuk ka rrënjë unitare, pra seria është stacionare. Gjatësinë e vonesës e kemi 0, maksimumi i vonesave është 5. Variabla të jashtëm nuk kemi domethënë nuk kemi as ndikimi orientues. Them i se vlera probabilitare e D (IHD) e rendit të parë është < 0.05 pra, IHD ka ndikim orientues.

4. REZULATET

Nga rezultatet e studimit të punuar në programin Eviews mund të konkludojmë se:

- Vlerat e variablit X (IHD-së) dhe Y (PBB-së) kanë shpërndarje normale.
- Ndikimi i investimeve të huaja direkte është pozitive dhe domethënëse. Nëse investimet e huaja direkte rriten me një njësi, produkti i brendshëm bruto rritet me 1.223414 njësi.
- Forma lineare e modelit tonë të regresionit është ajo e duhura.

- Lidhja midis IHD-ve dhe PBB është e fortë dhe pozitive.
- Shpërndarja e vlerave të mbetjeve është normale.
- Seria kohore Y është jostacionare dhe ka rrënjë unitare.
- Mbetjet janë homoskedastike.
- Mbetjet janë të pranishëm në korrelacionin serial.

5. PËRFUNDIMET

IHD kanë kontribuar në rritjen e PBB-së të Shqipërisë përmes injektimit të kapitalit të ri dhe financimit të projekteve të mëdha infrastrukturore dhe industriale. Këto investime kanë ndihmuar në përmirësimin e kapaciteteve prodhuese të vendit dhe kanë nxitur diversifikimin e ekonomisë, duke krijuar një bazë më të fortë për zhvillimin e ardhshëm.

Investimet e huaja kanë luajtur një rol kyç në përmirësimin e infrastrukturës, duke përfshirë sektorët e energjisë, transportit dhe telekomunikacionit. Projektet si ndërtimi i hidrocentraleve dhe gazsjellësit Trans Adriatic Pipeline (TAP) kanë përmirësuar ndjeshëm kapacitetet prodhuese të energjisë dhe lidhjet transportuese, duke kontribuar në zhvillimin ekonomik të rajoneve të ndryshme të vendit.

IHD kanë krijuar vende të reja pune dhe kanë ndihmuar në përmirësimin e aftësive dhe kompetencave të fuqisë punëtore shqiptare. Trajnimet dhe mundësitë e zhvillimit profesional të ofruara nga firmat e huaja kanë rritur kualifikimet e punonjësve lokalë, duke kontribuar në ngritjen e standardeve të punës dhe zhvillimin e kapitalit njerëzor.

Firmat shumëkombëshe kanë sjellë teknologji të avancuar dhe praktika të reja prodhimi që kanë përmirësuar produktivitetin dhe efikasitetin e sektorëve të ndryshëm të ekonomisë. Bashkëpunimi me firmat e huaja ka inkurajuar kërkimin dhe zhvillimin, duke rritur kapacitetin inovativ të vendit dhe përmirësuar konkurrencën e tij në tregjet ndërkombëtare.

Investimet e huaja kanë inkurajuar qeverinë shqiptare të ndërmarrë reforma për të përmirësuar kornizën ligjore dhe rregullatore, duke rritur transparencën dhe reduktuar korrupsionin. Këto përpjekje kanë krijuar një mjedis më të favorshëm për biznesin dhe kanë rritur besimin e investitorëve të huaj.

Investimet e huaja në Shqipëri duket se kanë kontribuar pozitivisht në rritjen ekonomike, duke mbështetur këndvështrimin teorik se IHD-të janë një faktor i rëndësishëm i rritjes ekonomike.

6. REKOMANDIME

Kuadri ligjor duhet të përforcohet, jo vetëm në aspektin e legjislacionit, por

edhe të zbatimit të tij dhe transparencës që lidhet me të, me rregulloret dhe procedurat.

Zvogëlimi i përmasave të ekonomisë informale do të ndihmonte jo vetëm në përmirësimin e ekonomisë në aspektin makroekonomik, por gjithashtu do të eliminonte pengesën më të madhe të biznesit të ligjshëm, që është konkurrenca e pandershme.

Infrastruktura ka nevojë për një zgjidhje, me qëllim nxitjen e investimeve të huaja në të gjithë Shqipërinë. Rritja e investimeve publike në infrastrukturë nuk është zgjidhja e vetme; përpjekje mund të bëhen në drejtim të tërheqjes së projekteve të huaja në këtë fushë, përmes ofrimit të stimujve të veçantë. Qeveria Shqiptare mund të inkurajojë zhvillimin e zonave të veçanta gjeografike brenda vendit, të cilat përfaqësojnë zona me mundësi të mëdha investimi në vend, duke u përpjekur ta bëjë të gjithë vendin më tërheqës. Zona të tilla janë ato industriale ose turistike (si për shembull, zonat bregdetare). Zhvillimi i këtyre zonave mund të kërkojë investime dhe burime të mëdha, por sigurisht që do të sjellin shumë të ardhura në vend.

Për të vazhduar tërheqjen dhe maksimizimin e përfitimeve nga IHD, Shqipëria duhet të vazhdojë me reformat ekonomike dhe institucionale, duke përmirësuar më tej klimën e biznesit dhe infrastrukturën. Investimet në arsim dhe trajnim profesional, si dhe zhvillimi i sektorëve strategjikë, janë të rëndësishme për të siguruar që vendi të përfitojë plotësisht nga investimet e huaja. Gjithashtu, mbajtja e një mjedisi të qëndrueshëm politik dhe ekonomik do të jetë kyç për tërheqjen e investitorëve të huaj dhe për të siguruar një rritje të qëndrueshme ekonomike.

Tërheqja e investitorëve të orientuar drejt sektorit të eksportit për produkte të prodhuara, jo vetëm eksport të produkteve primare, duhet stimuluar, pasi krijon mundësinë e diversifikimit të shportës së produkteve të eksportit dhe krijon produkte të sofistikuar. Diversifikimi i eksporteve është i rëndësishëm për arritjen e rritjes ekonomike të qëndrueshme.

7. REFERENCA

Mancellari, A., Papapanagos, H., Sanfey, P., & Talka, M. (2006). The Albanian economy in transition: the role of international organizations and foreign assistance. In *Albania and Europe in a Political Regard* (pp. 45-64).

UNCTAD. (2009). *The Role of International Investment Agreements in Attracting Foreign Direct Investment to Developing Countries*. United Nations Conference on Trade and Development.

UNCTAD. (2020). *World Investment Report 2020: International Production Beyond the Pandemic*. United Nations Conference on Trade and Development.

IMF. (2013). Republic of Albania: 2013 Article IV Consultation. International Monetary Fund.

Burime interneti

OECD (2009), Raport i Investimeve të huaja direkte në Shqipëri
<http://open.data.al/sq/lajme/lajm/id/Investimet-e-huaja-direkte-ne-Shqiperi-gjate-viteve-1993-2011>

Bank of Albania (2010) Annual report of 2009
http://www.bankofalbania.org/Raporti_Vjetor_ne_2010_1.php data of access 06.06.2011

Raportet vjetore INSTAT, (2021)
<https://www.instat.gov.al/media/9393/nd%C3%ABrmarjet-e-huaja-e-te-perbashketa-2018-2020.pdf>

Raporti i Investimeve të Huaja Direkte në Shqipëri, 2020.

https://www.bankofalbania.org/Statistikat/Statistikat_e_Sektorit_te_Jashtem/Investimet_e_huaja_direkte/

Strategjia e zhvillimit të biznesit dhe Investimeve (20010-2022) METE
www.aida.gov.al